




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština - Assembly



Legjislatura VIII
Sesioni Pranveror

Kryesia e Kuvendit, në mbështetje të nenit 67.6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neneve 4, paragrafi 1.2 dhe 19 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 7 prill 2023, në lidhje me pagat e deputetëve, stafit politik të Kuvendit dhe nëpunësve civil të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputeti i Kuvendit, Stafi mbështetës politik i Kuvendit dhe nëpunësi aktual i Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, nëse para hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 08/L-196 për pagat në sektorin publik, ka përfitur pagën bruto mujore më të madhe se paga e plotë e parashikuar me ligj, përfiton pagën e re dhe shtesën tranzitore të barabartë me diferencën ndërmjet pagës bruto mujore dhe pagës së re bazë, për periudhën e parashikuar në nenin 41, paragrafi 2 të Ligjit nr. 08/L-196 për pagat në sektorin publik.
2. Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Thesari i Kosovës që ekzekutimi i pagave për muajin prill 2023, të bëhet në pajtim pikën 1 të këtij vendimi, si dhe të bëhet rimbursimi për ndalesat e bëra në pagën e muajit shkurt dhe mars 2023..

Nr. 08-V- 439
Prishtinë, 07.04.2023

Glauk Konjufca

Kryetar i Kuvendit

Kopja e Vendimit u dërgohet:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Ministrisë së Punëve të Brendshme,
- Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve,
- Thesarit të Kosovës,
- Administratës së Kuvendit dhe
- Arkivit të Kuvendit.



demokracia